

**PERMBLEDHJE E MATERIALIT PER LEJE MJEDISORE TIPI B PER
AKTIVITETIN:
“ IMPIANT PRODHIM INERTESH NGA GURI GELQEROR SI DHE IMPIANT I
PRODHIMIT TE BETONIT, “ TE SUBJEKTIT “GEGA-G” ME ADMINISTRATOR
ISMET GEGA**

**SUBJEKTI “GEGA-G” SH.P.K
RRETHI LIBRAZHD, NJESIA ADMINISTRATIVE POLIS, MIRAKE**

- 1. HYRJE**
- 2. BAZA LIGJORE**
- 3. QELLIMI I VEPRIMTARISE**
- 4. PERSHKRIMI I VENDODHJES**
- 5. PERSHKRIMI I TEKNOLLOJISE**
- 6. INFORMACIONE MBI CILESINE E AJRIT**
- 7. INFORMACION MBI SHKARKIMET NE MJEDIS, IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE
NE MJEDIS TE AKTIVITETIT MASAT KRYESORE LEHTESUESE**
- 8. PROGRAMI MENAXHIMIT**
- 9. PROGRAMI MONITORIMIT**
- REKOMANDIME-KONKLUZIONE**

Hyrje

Rajoni i Shqiperise Qendrore ku ben pjese dhe zona e Mirakes, e zgjedhur per ngritjen dhe funksjonimin e linjes se prodhimit te materialeve inerte; linjes per prodhimin e betonit si dhe infrastruktures mbeshtetese te sajë (oficine, magazine, pike kerburanti, zyra etj) nga subjekti “GEGA-G ” sh.p.k. eshte nder hapesirat e rendesishme dhe me te vlefshme te vendit, e pare nga ky kend veshtrim, nga ai i zhvillimit ekonomik dhe vlerave mjedisore qe ajo paraqet.

Ne zhvillimin ekonomik-shoqeror te nje vendi, gjithnje ne perputhje me parimet universale te zhvillimit te qendrueshem, marrin nje rendesi te vecante gjetja e rrugeve dhe teknologjive me efikase, si per shfrytezimin sa me rracional te pasurive natyrore, ashtu dhe per kontrollin cilesor dhe sasiore te ndikimit ne mjedis.

Gjate dekadave te fundit veprimtari te ndryshme kane ndikuar dukshem ne mjedisin rrethues ne pergjithesi. Ndryshimet e sistemit te zhvillimit ekonomik te vendit duke u orientuar drejt ekonomise se tregut ka bere qe konsumatori te kerkoje me shume cilesi produkti dhe kulture sherbimi.

Vendi yne eshte antare i nje numri konventash nderkombetare si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoje nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomike -sociale-mjedisore dhe per rregullimin e territorit, sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore. Mjedisit eshte burim i gjithçkaje per te cilen njerezit kane nevojë per te jetuar dhe per tu zhvilluar. Sa me i degraduar te jete mjedisit aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik - social. Prandaj duhet nje menaxhim sa me i mire i mjedisit natyror ne lidhje me aktivitetin njerezor qe po zhvillohet çdo dite e me shume. Ne Shqiperi, zhvillimi i veprimtarise ekonomike dhe tranzicioni i veshtire drejt ekonomise se tregut ka ushtruar trusni te forte ne mjedis duke ndikuar negativisht ne te. Investimet e reja kane sjelle ndikime ne mjedis, por tashme eshte arritur qe shume prej veprimtarive qe ushtrojne aktivitet brenda territorit te Republikes se Shqiperise ti nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis perpara miratimit dhe zbatimit tyre si qellim per te parandaluar krijimin e zonave te tjera te ndotura. Ky qellim eshte kaq i rendesishem saqe theksojme qe parandalimi eshte edhe me i mire edhe me pak i kushtueshem se sa kurimi.

Baza ligjore ku mbeshitet veprimtaria e projektit.

Eksperti mjedisore është mbeshitetur në bazën ligjore të listuar më poshtë në zgjedhjen e teknologjise dhe instalimin e saj. Subjekti zotohet të zbatohet me korrektesë të gjithë këto baza ligjore, V.K.M., rregullore të ndryshme si dhe të adoptohet aktivitetin e saj me bazën ligjore të re nëse behen ndryshime. Ligjet baze janë:

- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, “ Për lejet e mjedisit”;
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- Ligji Nr. 8766, date 05.04.2001 , “Te mbrojtjes ndaj zjarrit”;
- Ligji Nr. 9010, date 13.02.2002, “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta;
- Ligji Nr. 9108, date 17.07.2003, “ Per substancat dhe preparatet kimike”;
- Ligji Nr 8770 date 19.04.2001 “Per sherbimine ruajties dhe sigurise fizike”;
- Ligji Nr 8756 date 26.03.2001 ‘Per mbrojtjen nga zjarri”;
- Ligji Nr.9244, date 17.06.2004 “Per mbrojtjen e tokes bujqesore”;
- Ligji Nr.9385, date 04.05.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor”;
- Ligji Nr.9587, date 20.07.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”;
- V.K.M.Nr.419, date 25.06.2014” Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisore te tipeve A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt tek tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kopetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja”;
- *V.K.M. Nr.417*, date 25.06.2014 ”Per miratimin e tarifave te lejeve te mjedisit”;
- V.K.M. Nr.435, date 12.09.2002,“Per Normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”;
- V.K.M. Nr.1189, date 18.1.2009,”Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit”;
- V.K.M. Nr.177, date 31.03.2005, “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisve ujore pritesë”;
- V.K.M.Nr.765, datë 7.11.2012”Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”;
- V.K.M. Nr.99, datë 18.02.2005 i Këshillit të Ministrave, “ Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve ”;
- V.K.M.Nr.587, date 07.07.2010,”Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane dhe turistike”;

- V.K.M.Nr.13, date 14.01.2013 ”Per miratimin e rregullave, afateve dhe pergjegjsive per informimin dhe pjesmarjen e publikut gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis”;
- Udhezimi Nr.8, date 27.11.2007, ”Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara.
- Udhezimi Nr.429, date 17.11.2009, i Ministrit te Mjedisit, “Per rregullat dhe procedurat per paisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit”;
- Udhezimi Nr.6527 date 24/12/2004 “Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mynyrat e kontrollit te tyre“;
- Rregulloren Nr.1, date 15.03.2006, “Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis te veprimtarive ndertimore“;
- Rregullore Nr. 1, date 30.03.2007, „Per trajtimet e mbetjeve te ndertimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjesimi i tyre“.

Projekti zbatohet gjithashtu edhe ne perputhje me ligjet dhe aktet nenligjore per urbanistiken dhe organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Qellimi i veprimtarise

Projekti i propozuar per tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi B ka si qellim funksionimin e linjes se prodhimit te materialeve inerte, prodhimin e betonit nga keto lende te para si dhe infrastrukturen mbeshtetese te saje (oficine, pike karburanti per furnizimin e makinave betonjere, magazine, zyra etj) nga subjekti “GEGA-G”sh.p.k.

Per nje funksionim sa me optimal dhe me cilesi qe synohen te ofrohen, jane ndertuar objektet dhe infrastruktura e cila do mbeshtese aktivitetin e mesiperm. Investitori po zhvillon prej vitesh kete veprimtari , ka mjetet e nevojshme teknike dhe nje staf te caktuar posacerisht per kete veprimtari , ka si synim ruajtjen e shtreterve te lumenje sipas ligjeve, akteve ligjore dhe nenligjore, urdheresave dhe udhezimeve per kete synim, mbajtjen paster te rrugeve dhe shesheve perberese te tij , mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te njeriut si dhe mbrojtja e mjedisit ne zbatim te ligjeve te dala ne vite per te minimizuar ndotjet. Ky raport eshte hartuar per te identifikuar ndikimet negative ne mjedis te kesaj veprimtarie dhe propozimet per masat zbutese te tyre. Duhet thene se specialistet kane pasur per baze Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011, ”Per Lejet e Mjedisit”, neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” si dhe Ligjin Nr.10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe aktet e tjera normative qe lidhen me te”;

Ne shfrytezimin e linjes se prodhimit te inerteve dhe te betonit, si dhe infrastrukturen mbeshtetese te saj (oficine, magazine,pike karburanti, zyra etj) nga subjekti “GEGA-G ”sh.p.k., subjekti do te marre te gjitha masat per zbatimin me perpikmeri te projektit te hartuar qe ai te siguroje nje zhvillim normal te proçesit te prodhimit pa demtuar mjedisin.

Aktiviteti i subjektit te siperpermendur eshte ndermerre si nje inisiativë qe do te tentoje pervec rritjes se fitimit te investitorit edhe ne :

- Shfrytezimin dhe perdorimin e lendes se pare ne vend;
- Rritjen e punesimeve ne zonen perreth;
- Permiresimin e sistemit te ndertimit dhe infrastruktures rrugore ne nivele lokale.

Pershkrimi i vendodhjes se veprimtarise shoqeruar me harten ilustruese dhe fotografi nga objekti.

Veprimtaria ushtrohet ne rrethin Librazhd , Mirake, Njesisa administrative Polis , prane tynelit hekurudhor, ne ish objektin e Gurores se Ndermarjes se Ndertimit. Nga ana e subjektit eshte marre Leja e ndertimit qe ne vitin 2003 me Vendim te KRRT Librazhd Nr.8, date 04.03.2003 si dhe eshte zgjatur afat i saj per montimin e makinerive te linjes se inerteve dhe betonit me date 16.06.2012 me Vendim Nr.16 te KRRT Librazhd. Njekohesisht subjekti per kete aktivitet eshte pajisur me Autorizim Mjedisor.

Pershkrimi i veprave inxhinjrike dhe veprave te domosdoshme per zbatimin e projektit.

Ne hapesiren e territorit ku do te zhvillohet veprimtaria eshte instaluar teknologjia qe sherben per ushtrimin e veprimtarise si dhe eshte ndertuar infrastruktura e sherbimeve mbeshtetese te operacioneve. Nder njesite dhe veprat kryesore te projektit jane:

- Sheshi depozitimit te materialit;
- Linja e prodhimit te inerteve te gurit
- Linja e prodhimit te betonit ;
- Sheshi Parkimi i automjeteve+garazhi;
- Magazina;
- Oficina;
- Pika e karburantit;
- Zyra e kantjerit ;
- Kabine elektrike

Krahas tyre eshte ndertuar

- 1.Sistemi i kanalizimeve dhe parandalimit te ndotjes se mjedisit, puseta dhe kanale mbledhes te ujrave.
- 2.Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, fikse zjarri portative, kosha metalike , tabela sinjalizuese, rezervar uji i lidhur me nje pompe qe siguron uje me presjon ne te gjithë ambjentet e punes.
- 3.Sistemi i rrjetit elektrik, telefonik dhe atij hidrik per ushtrimin e veprimtarise.
4. Sistemi rrugor.

Pershkrimi i proceseve teknologjike.

Impianti i prodhimit te inerteve prej guri dhe betonit

Teknologjia e prodhimit te inerteve dhe e betonit eshte teknologji e thjeshte e standarteve europiane.

Produkte te ketij impianti do te jete prrodhimi i inerteve prej guri me dimensionete ndryshme si dhe prodhimi i betonit te markave te ndryshme sipas kerkesave te tregut. Linja e prodhimit ka nje kapacitet prodhues variabel dhe punon me cikël te mbyllur. Produkti i ketij impianti do te furnizojë industrine e ndertimit ne zone e me gjere.

Ne baze te fraksioneve inerte te perdorura, raporteve midis tyre dhe aditiveve te lidhjes se granulave (cimento) ne impiant do te prodhohet beton.

Lendet e para.


Lenda e pare qe perdoret per prodhimin e inerteve eshte guri gelqeror qe del nga shfrytezimi i karrieres gurore te vete subjektit” GEGA-G” , i cile eshte pajisur me Leje shfrytezimi minerare Nr.1747 date 02.04.2015, nga Ministria Energjise dhe Industrise si dhe eshte pajisur me Leje Mjediosre Nr.3418/2 date 01.07.2010, Vendim Nr. 16 te Komisionit te Lejeve, dhe e konfirmuar kjo Leje e vlefsheme nga AKM, me shkrese Nr.407, date 23.03.2015.

Pershkrimi dhe Volumet e Punimeve Punimet konsistojne ne transportim, depozitim dhe perpunim te gurit gelqeror per prodhimin e materialeve te ndertimit dhe betonit. Punimet e instalimit konsistojne ne transportimin e paisjeve si sillosa, elektromotorra, elektropompa, transportier, mulliri prerjes se gurit, profile te ndarjes se vend-depozitimit e inerteve, mjete rrethuese, depozita uji, etj.

Kjo linje teknologjike sipas proceseve qe realizon perbehet nga keto njesi baze:

Bunkeri i depozitimit te materialeve inerteve qe vijne nga karriera .

Bunkeri eshte edhe stacioni i pare i materialit inert i cili i nenshtrohet nje numri te caktuar procesesh. Materiali inert qe depozitohet ketu do te jete gjithmone ne gjendje te lagur pasi do te sperkatet me uje per efekt te eliminimit te clirimit te pluhurave gjate procesit te thyerjes se tij. Bunkeri i depozitimit ka formen e nje hinke me fund nga siper, nje kapacitet volumetrik relativ prej 20 m³ , i ndertuar prej metali celiku me diameter flete prej 0.8 mm bunkeri eshte teper rezistent ndaj forcave mekanike. Ne bunker shkarkohet materiali inerte i cili nepermjet forces terheqese gravitacionale drejtohet ne sistemin e bluarjes ose coptimit si dhe ne sistemin e sitosjes. Kalimi i materialit behet nepermjet transportjereve, dhe ndarja e tij behet ne sita perkatese



Skema teknologjike

- A. Kabine Elektrike
- 1. Transportiere L=20 metra
- 2. Transportier L=20 metra
- 3. Transportiere L=20 metra
- 4. Transportier L=20 metra
- 5. Transportier L=16 metra
- 6. Transportier L=12 metra

7. Larese (ne se do te perdoret rere lumi) $S=15 \text{ m}^2$
8. Site me dy kate $S=10 \text{ m}^2$
9. Transportier $L=21 \text{ metra}$
10. Fronto
11. Site me dy kate $S=2 \text{ m}^2$
12. Pompe uji $Q=4 \text{ m}^3/\text{min}$
13. Transportier $L=21 \text{ metra}$
14. Site me dy kate $S=6 \text{ m}^2$
15. Transportier $L= 20 \text{ metra}$
16. Transportier $L=16 \text{ metra}$
17. Transportier $L=20 \text{ metra}$
18. Site me dy kate $S=6 \text{ m}^2$
19. Transportier $L=21 \text{ metra}$
20. Transportier $L=10 \text{ metra}$
21. Mulli $60 \times 40 \text{ cm}$
22. Mulli $40 \times 40 \text{ cm}$
23. transportier $L=23 \text{ metra}$
24. Bunker dozatore 20 m^3
- A. Pult komandimi $5 \times 3 \text{ metra}$
- B. Kabine elektrike $7 \times 3 \text{ metra}$

Treguesit fiziko – mekanik dhe kimik te lendes se pare

Lenda e pare qe do te perdoret per prodhim betoni do te jene inertet e perpunuara nga impianti dhe nga analizat e bere rezultojne keta tregues: Ne aspektin litologjik perberja e inerteve eshte :

Gelqeror 45%

Ranor 40%

Magmatik 10%

Shkembej te tjere 5%

Vetite fizikeo-mekanike te tij jane:

Masa vellimore 2.483 gr/cm^3

Masa specifike $2,58 \text{ gr/cm}^3$

Rezistenca ne shtypje $700-1200 \text{ kg/cm}^2$

Poroziteti $0,9\%$

Koeficjenti zbutjes $0,27$

Perberja granulometrike e materialit qe do te shfrytezohet sipas analizave laboratorike eshte si me poshte:

Inerte me permasa mbi 30 mm 23.7%

Inerte me permasa	0-5 mm	30.3%
Inerte me permasa	5-12mm	25 %
Inerte me permasa	12-30mm	21 %

Përshkrimi i procesit teknologjik te punes.

Materialet inerte qe do te perdoren per prodhimin e betonit sipas klasave te ndryshme do te jene te cilesise se larte dhe konform kushteve te cisesise per keto produkte. Inerti qe do te perdoret eshte paraprakisht i pastert . Linja e prodhimit te betonit perbehet nga sheshi i depozitimit te ruajtjes se fraksioneve te granilit dhe reres dhe dy sillose per depozitimin e cimentos. Sistemi i drejtimit te prodhimit, ndodhet ne nje kabine e cila eshte elektronike me parametra bashkekohore. Markat e betonit prodhohen sipas kushteve teknike teknologjike dhe realizohen ne funksion te kerkesave te subjekteve juridike dhe fizike te bazuara ne projektet e preventivat e hartuara.

Betoni eshte material qe nuk gjendet ne natyre ne menyre te drejtperdrejt por krijohet me perzierjen e komponenteve perberese : cimentoja , agregateti (rere, zall) , uji dhe ne te shumten e rasteve edhe aditive, shtesave mineralogjike etj. Cimentoja si lende lidhese pas veprimit me ujin krijon nje strukture se bashku me agregatin qe me kohen ngurtesohet. Agregati paraqitet si mbushes qe ze pjesen me te madhe ne masen e betonit. Uji zakonisht perdoret me $\text{ph}=7$. Aditivet si komponente mund te themi se jane te domosdoshme sa i perket prodhimit te betonit dhe ate qe te permbushin kushtet e betonit te parashtruara me kerkesa te caktuara (psh i papershkueshem ndaj ujit, qendrueshem ndaj ngrirjes/shkrirjes etj). Shtesat mineralogjike si komponente perdoren kur deshirojme qe te arrijme rezultate te larta ne nej drejtim, ndersa ne anen tjetër mos te shkaktohen rezultate te uleta ne drejtimet tjera (psh te rritet soliditeti ne shtypje duke mos rritur shume sasine e cimentos). Betoni si material ka aftesi qe ne gjendje te njome te marre forma te cfaredoshme dhe ate forme ta mbaje pas ngurtesimit me nej aftesi te konsideruar mbajtese. Prodhimi i betonit sipas kerkesave te caktuara kerkon percaktimin e sakte te sasise se materialeve perberes te tij. Ne percaktimin e sasise se cimentos duhet te kihet kujdes qe te merren ne konsiderate keto elemente: - Betoni qe do te perdoret - Dimensionet e elementit apo konstruksionit - Nxehtesia e hidracionit ne beton - Aspekti i ekspozimit te konstruksionit Meqenese agregati si komponente i betonit eshte me i lire ne krahasim me cimenton atehere edhe perdorimi i tij eshte ne sasi me te madhe ne prodhimin e betonit. Po ashtu ndikimi i agregatit eshte i konsiderueshem ne stabilitetin vellimor dhe jetegjatesine e betonit. Ne varesi te kerkeses per llojin e caktuar te betonit , me veti te caktuara behet edhe percaktimi i sasise se aditiveve. Betoni i njome eshte perzierje e ujit, cimentos, agregatit, aditiveve dhe eventualisht shtesave

mineralogjike. Pas perzierjes se komponenteve perberese qellimi eshte prodhimi i nje mase uniforme, te pershtatshme per transport , hedhje ne veper, ngjeshje dhe rrafshim te siperfaqeve kur eshte ne gjendje te njome. Vetite me te rendesishme te betonit te njome jane:

- 1- Perpunueshmeria (konsistenca) e betonit te njome Ne menyre praktike perpunueshmeria qendron ne lehtesine e hedhjes se betonit derisa te marr formen perfundimtare. Konsistenca e betonit paraqet shkallen e plasticitetit te betonit dhe nderlidhet me aftesine e betonit te njome qe hidhet ne veper dhe mundeson nje ngjeshmeri te mire.
- 2- Masa vellimore e betonit te njome
- 3- Sasia e ajrit (poreve) ne beton

Lendet e para per perkatitjen e betonit dhe produktet perfundimtare

a-Perbersit e betonit marka 300

1-Cemento Portland 42.5R

-Densiteti: 3.0gr/cm³

-Koha e ngrirjes Fillimi 110 minuta Mbarimi 160 minuta

-Rezistenca 28 ditore 55.0 Mpa

2- Rere natyrale 0-3 mm

-Pesha specifike 2.685 g/cm³

- Moduli I imtesise 3.1

-Pesha vellimore 1462

3- Rere betoni 3-5 mm

-Pesha specifike 2.690 g/cm³

-Moduli i imtesise 86

-Masa vellimore 463 kg/m³

4- Granil "1" (5-10) mm

-Pesha specifike 2.695gr/cm³

- Moduli i imtesise 5.9

-Masa vellimore 15463 kg/m³

5- Granil"2" (10-20) mm

-Pesha specifike 2.697gr/cm³

-Moduli i imtesise 7.29

- Masa vellimore 1506 kg/cm³

Per marken e betonit 300 p

- 1- Cimento 400kg/m³
- 2- Aditiv 2. 125litra
- 3- Inerte 1862.5kg
- 4- Uji 143.7 litra
- 5- Lageshtia 6,50%
- 6- Pesha vellimore 2408kg/m³
- 7- Konsistenca 11.5cm
- 8- Raporti uji/cimento 0.373

Ne lidhje me ngarkimin dhe transportin eshte parashikuar qe pajisjet do te perbehen nga makina ngarkuese, kamion vetshkarkues, etj. Kjo zgjidhje behet per shkak te adaptueshmerise dhe fleksibilitetit te larte qe kane keto lloj pajisje, shkalles se larte te disponueshmerise, si dhe mundesine per ti kombinuar ato per te realizuar punime te ndryshme sipas nevojave te prodhimit. Nevojat per ngarkim percaktohen nga numri i kamionve te nevojshem qe varen nga distanca e transportimit, disponueshmeria per pune e makinave ngarkuese dhe e kamioneve, oret e punes ne dispozicion per dite/turn, etj. Koha ne dispozicion per ngarkim eshte 8 ore/turn ose dite. Koha e nevojshme per nje cikel te plote te makines ngarkuese per te ngarkuar materialin nga pingu me materiale ne kamion eshte 60 minuta. Koeficienti i mbushjes se koves se makines ngarkuese zakonisht eshte 80%.

Pershkrimi dhe Volumet e Punimeve.

Punimet konsistojne ne transportimin, depozitim dhe perpunimin e materialeve inerte per prodhim betoni. Punimet e instalimit konsistojne ne transportimin e paisjeve si sillosa, elektromotorra, elektropompa, transportier, profile te ndarjes se vend-depozitimitt e inerteve, mjete rrethuese, depozita uji, etj.

Skema teknologjike e prodhimit te betonit

4.1 Programi i punes

Per zhvillimin e projektit eshte kaluar ne disa faza - Fillimisht eshte vendosur zona ne te cilet do ndertohet linja e prodhimit - Ndarja e sheshit ne zona perkatesisht per zonen ku do te depozitohen lendet e para, parkimi i automjeteve etj - Faza e fundit ka te bej me sistemimin e linjes per zhvillimin e prodhimit te betonit

4.2 Plani i instalimit te linjes dhe afati zbatimit te tij

Fazat qe jane planifikuar per instalimin e linjes se prodhimit te betonit jane:

4.3 Furnizimin me uje. Uji i pijshem per furnizimin e objektit dhe plotesimin e kerkesave te personelit qe do te punoje , do te merret nga tubacioni kryesor i ujesjellesit te zones. Lidhja e objektit me tubacionin kryesor te ujesjellesit dhe kontratat per vendosjen e kontatoreve behet me marrveshje me ndermarrjen e ujesjelles kanalizime. Zona ka infrastrukturen te ngritur persa i perket furnizimit me uje, sepse kjo zone ka shume vite qe funksionon si e tille. Nderhyrjet ne rrjete do te jene ne funksion te permiresimit te furnizimit me uje te pijshem.

4.4- Rrjeti i kanalizimeve te ujerave te zeza. Ne funksion te nevojave te objektit te sherbimit do te perdoret rrjeti ekzistues i kanalizimeve. Sistemi i evakuimit te ujerave te zeza per vete karakteristikat e kanalizimeve te zones do te jete nje sistem unitar. Perberja e ujrave te zeza nga destinacioni qe ka zona do te jene ujera komunale, te dala nga objekti. Normat e perdorimit te ujit per aktivitetin jane percaktuar nga destinacioni i perdorimit te ambjenteve te sherbimit, pas miratimit perfundimtar te projektit. Rakordimi altimetrik dhe planimetrik i rrjetit eshte realizuar me puseta te pergatitura ne vend. Gjithashtu ne rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza jane vendosur puseta kontrolli ne distance 50m nga njera tjetra, ne largesi lineare te rrjetit. Evakuimi i ujrave atmosferike do te realizohet me ane te sistemit te kunetave dhe pusetave te vendosura ne anet e rrugeve duke i derguar ato drejte kolektoreve rrugore. Kolektimi i te gjitha ujrave te zones do te realizohet ne kolektoret kryesore.

4.5.Furnizimi me energji elektrike Per furnizimin me energji elektrike jane bere instalime te reja dhe eshte ndertuar kabine elektrike. Furnizimi me energji elektrike behet ne baze te kontrates qe eshte lidhur me sistemin shperndares.

4.6- Faza e funksionimit Ne kete impiant jane te perfshira silloset e cimentos , silloset e ujit, diafragma prej betoni dhe vaskat e materialeve te granilit te fraksionuar, rere guri. Procesi i punes fillon me afrimin e materialeve prane bunkerit me ane te eskavatorit me rrota. Autobetoniera afrohet prane transportierit levizes ku me aten e te cilit transportohet materiali sipas gramaturave te percaktuar per cdo marke betoni. Ne fund te transportierit levizes ndodhet nje hinke ku injektohet sasia e cimentos dhe e ujit njekohesisht. Hedhja e sasive te materialeve behet ne menyre automatike, impianti jep ne monitor marken e betonit te kerkuar si dhe sasine. Impianti ne menyre automatike ben nxjerrjen e materialeve te granilit dhe reses ne sasite e caktuar dhe njekohesisht behet dhe injektimi i cimentos dhe ujit. Perzierja e materialit behet ne betonierat.

Informacion per cilesine e ajrit dhe ujrave sipërfaqësore ne zonen e veprimtarise ku do te kryhen shkarkimet ne mjedis. Nje pershkrim i gjendjes dhe i vlerave egzistuese te mjedisit qe mund te ndikohen nga zbatimi i projektit te propozuar

Te dhenat per Qarkun Elbasan, Njesine Administrative Polis, Klimen dhe natyren, Popullsia aktiviteti ekonomik etj.

Ne perberje te tij jane **kater rrethe**: Rrethi **Elbasan**, qe eshte edhe qendra e ketij qarku, Rrethi **Librazhd**, Rrethi **Peqin**, Rrethi **Gramsh**.

Administrativisht, Qarku ka 7 bashki, 43 Njesi Administrative dhe 386 fshatra.

Qarku i Elbasanit kufizohet:

- në Veri me Qarkun e Dibrës
- në Veri-Perëndim me Qarkun e Tiranës
- në Perëndim me Qarkun e Fierit
- në Jug me Qarkun e Beratit
- në Jug-Lindje me Qarkun e Korçës
- në Lindje me Republikën e Maqedonisë

Rrethi Librazhd ka dy bashki Librazhd dhe Prrenjas

I. Bashkia Librazhd perfshin Bashkine Librazhd, Njesine administrative Hotolisht, Lunik, Orenje, Polis, Librazhd Qender

II. Bashkia Prrenjas perfshin Bashkine Prrenjas, Njesine Administrative Qukes, Rrajce, Stebleve, Stravaj.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet ne mjedis gjate funksionimit te impiantit te prodhimit te inerteve dhe prodhimit te betonit do te jene kryesisht pluhuri i lendes pare , si dhe zhurma e impiantit te perpunimit te gurit dhe ne rast te mundshem derdhje te cimentos ne sheshin e prodhimit. Procesi i prodhimit te betonit perfshine edhe perdorimin e ujit, si pjese e procesit teknologjik, kjo sherben per tretjen e cimentos dhe furnizimin e autobetoniereve me uje per procesin e lagies se materialit te perzier. Proces tjetër është edhe larja e pastrimi i autobetoniereve pas shkarkimit te betonit, ne menyre qe te mos ngrije material ne depoziten e perziersit te betonit. Keto ujera do te jene me cemento. Per kete arsye, drejtuesit e ketyre mjeteve duhet te trajnohen per te kryer kete proces ne kantierin e prodhimit, vasken e dekantimit dhe jo ne cdo mjedis te mundshem. Uji eshte me cikël te mbyllur dhe kalon nepermjet nje vasje dekantimi, mбетjet e vaskes jane ne trajte llumrash dhe

menaxhohen si mbetje te ngurta. Per humbjet e ujit gjate procesit te punes dhe avullimit, shtohet uje nga sistemi furnizimit.

Cilësia e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën ne vleresim per zonen e Mirakes jane te monitoruara tashme nga subjekti. Nuk vleresohet ndotje kimike ne kete subjekt.

Identifikimi i burimeve ujore ne afersi te aktivitetit. Ne afersi te aktivitetit, nuk identifikohen burime ujore, si rrjedhoje per plotesimin e nevojave eshte linja e furnizimit me uje nga ujesjellesi i zones. Burimi ujqor me i rendesishem i zones eshte lumi Shkumbin, i cili kalon ne distance te 50m nga sheshi ne vleresim.

Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes se zones ne vleresim. Kjo zone ka nje bimesi te uket dhe ne lartesi jane mbjelke pisha dhe nuk ka ndryshime te mbuleses bimore .

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE AKTIVITETIT

Te pergjithshme.

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem. Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerën prej fazave kryesore; faza e funksionimit, pasi nuk perfshihen procese ndertimi ne kete linje. Nuk marrim ne konsiderate fazen pas perfundimit te veprimtarise pasi ky aktivitet do te vazhdoje te jete i tille ne vazhdimesi. Ky aktivitet nuk prek zona me bimesi, ndodhet ne brendesi te sheshit te ish Ndermarrjes se ndertimit e cila eshte e miratuar per shfrytezim dhe per ndertim. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Vleresim i impakteve kryesore ne mjedis

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane: Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake, Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore, Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit, Parimi i qasjes së integruar, Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit, Parimi “Ndotësi pagan”, Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut, Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit. Ky vleresim eshte ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe te ish VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” (sot VKM Nr.686, date 29.07.2015”per miratimin e rregullave,

te pergjegjesive e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis(VNM) dhe Procedures se Transferimit te Vendimit e Deklarates Mjedisore).

Qellimi i raportit te vleresimit ne mjedis i pergatitur me pare per kete subjekt, eshte qe te indentifikoje pasojat e mundeshme negative mjedisore qe mund te krijohen si gjate shfrytezimit te ketij aktiviteti.(meqenese aktiviteti ka kohe qe zhvillohet dhe subjekti ka qene pajisur me Autorizim Mjedisor me pare) pra ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparesi kombetare dhe eshte e detyrueshme per cdo banor te Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Sa me siper vleresimi i ndikimeve ne mjedis do te vleresoje:

Ndikimet ne ajer;

Ndikimet ne ujera;

Ndikimet ne toke ;

Ndikimet ne biodiversitet (mjedisi biologjik);

Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik;

Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike.

Ndikimet e pritshme ne mjedis

Ndikimet e analizuara gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

Shkarkimet ne ujera

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) Pastrimi i ambjentit ne rast te shkarkimit te cimentos se lengshme, kryesisht nga nderprerja e punes per shkak te nderprerjeve te energjise elektrike ose avari te tjera;

- b) Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambjentin e kantierit, larja e autobetoniereve dhe e materialit;
- c) Ujerat e siperfaqsores se sheshit te qarkullimit te automjeteve;
- d) Ujerat e perdorura per ambjentet higjenosanitare te ambjentit te stafit;
- e) Ujerat siperfaqsores nga shplarja e materialit nga rreshjet.

Lidhur me ujerat qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk perzihen me ujrat teknologjike, por kalojne ne sistem kanalizimi dhe te lidhen me kolektorin e zones. Nuk ka ujera industriale. Perdoret vetem uje per sprucimin e lendes se pare me qellim qe te mos krijohen pluhura, ndersa uji per beton perdoret ne sasi te planifikuara dhe nuk ka derdhje te tij ne mjediset e jashtme. Duke marre ne konsiderate respektimin e kushteve teknike ne kete objekt, mundesite e ndotjes nga rastet e emergjencave jane te rralla. Ndikimi nuk eshte me efekt domethenes ne mjedisin e zones.

Ndotja e tokes

Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem; Sistemi i transportimit dhe ngarkim shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Sistemi i terminalit te ngarkimit dhe shkarkimit eshte i shtruar me beton, si rrjedhoje nuk mund te kete ndotje te tokes, ne raste te derdhjes se lendes se cimentos ne mjedis. Kamionet jane veteshkarkues dhe materiali inerte qe do perdoret terhiqet vete nga sistemi i sillozes se makinerise. Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te subjektit per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne vende te papercaktuara. Gjithashtu siperfaqja e tokes ku automjetet kryejne ngarkimin dhe shkarkimin e lendes se pare dhe produktit eshte e betonuar dhe nuk ekziston mundesia e ndotjes se tokes nga shkarkimet ne mjedis. Automjetet dhe makinerite duhet te jene te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartur papasterti te tjera gjate transportit ne zonat urbane dhe me rruge te asfaltuara. Shkarkimi ne toke i elementeve te demshem per mjedisin, shkakton ndotje serioze ne mjedis, ndaj rekomandohet qe aktivitetet te jene te paisura me masa mbrojtese dhe te shtrojne siperfaqet ku ato veprojne. Ne se ndotet toka, ndikon edhe ne ndotjen e ujerave nentokesore.

Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit vjen nga pluhuri i granilit , si dhe nga aktiviteti i ngarkimit e shkarkimit te materialit. Transporti i materialit shkakton gjithashtu pluhura ne mjedis, ndonese rekomandohet lagia e sheshit te linjave. Procesi punes se linjes se prodhimit te inerteve gurore dhe betonit nuk perfshin procese te perdorimit te lendes djegese dhe nuk ka clirime te gazeve te demshme per mjedisin. Persa i perkete zhurmave, ato jane te ndjeshme vetem brenda ambjenteve te linjave dhe nuk jane problem per mjediset e jashteme(zona eshte ne afersi re rruges nacionale Elbasan-Librazhd).

Mbetjet e ngurta

Mbeturinat e ngurta vijne nga: Aktiviteti human, mbetje urbane te plastikës, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones. Nga aktiviteti vleresohet te kete mbetje te ngurta inerte por ato grumbullohen dhe riciklohen ndersa ambalazhet e ndryshme, si plastmas, leter, karton paleta druri grumbullohen dhe i jepen subjekteve te licensuara per riciklim.

MASAT KRYESORE LEHTESUESE

Masat lehtesuese qe duhet te merren gjate zhvillimit te aktivitetit. Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane relativisht te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithatë perparasite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet. Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- a) Duhet te tregohet kujdes ne respektimin rigoroz te kushteve teknike ne objekt per te reduktuar mundesite e avarive gjate punes;
- b) Parandalimi i shkarkimeve te lendes pare ne mjedis;
- c) Lidhur me mbetjet e grumbulluara te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara ose me subjektin e grumbullimit te mbetjeve urbane;
- d) Sasia depozituese e inerteve te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme dhe te demtoje peizazhin;
- e) Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes;
- f) Te mbillet nje brez pemesh te larta pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh;
- g) Te aplikohet lagia e shesheve ku qarkullojne automjetet;
- i) Te pastrohesh here pas here vaska dekantimi per ujerat e perdorura dhe mbetjet te riciklohen;

j) Te orientohen ujerat e rreshjeve dhe te larjes ne vasken e dekantimit.

PROGRAMI MONITORIMIT

Skema e monitorimit te treguesve mjedisor.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes dhe mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kritereve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv. Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve;
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre;
- Per te evidentuar cilesine e mjediseseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre;
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore. Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te Vendimit Nr.1189. date 18.11.2009 Per monitorimet ne Republiken e Shqiperise Investitori do te monitoroje keto treguese te trysnise ne mjedis vetem per pikat ku ai ndikon dhe konkretisht elementet e meposhtem:

Per ajrin duhet te monitoroje Lenden e Ngurte Pezull (LNP) dhe zhurmat ne ambientin e punes(dB).

Per ujin nuk ka shkarkime te pakontrolluara

Per token, nuk alikohen detyrime;

Per zhurmat nuk ka problem sepse zona eshte larg zonave te banuara dhe eshte ne afersi te rruges nacionale Elbasan-Librazhd, megjthate nga ana e subjektit te monitorohen ato duke u bazuar ne normat mjedisore te zones me qarkullim rrugor .

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet ne aktin e miratimit te lejes se mjedisit dhe ne rast te kundert, sipas kuadrit ligjor dhe cdo 6 muaj te dorezohet nje relacion periodik i shkurter ku te pasqyrohen punimet e kryera dhe masat e marra per menaxhimin e mbetjeve te ngurta ne menyre te integruar, keto te shoqeruara me foto.

REKOMANDIME

- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore;
- Te perdoret lende djegese e cilesise se pare per mjetet e transportit, ku niveli i squfurit te jete brenda normes se lejuar prej 10ppm;
- Te aplikohet larja e shesheve te pa shtruara per te reduktuar pluhurin;
- Te mos depozitohet lende e pare ne sasi te medha, per te reduktuar demtimin e peizazhit dhe te erozionit te eres dhe te shiut;
- Te mirembahen mjediset e gjelberuar ne menyre te perhershme dhe te mbillen edhe peme te larta pergjate murit rrethues te objektit;
- Te kryhet larja e automjeteve te transportit ne menyre periodike.
- Te vendosen kosha dhe postera sensibilizues per mbajtjen paster te ambjenteve;
- Investitori te respektoje detyrimet e vena ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM);
- Subjekti te respektoje te gjitha masat e percaktuara ne kete raport te VNM-se;
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij;
- Te kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve ne fuqi dhe te dergohet nje relacion shkresor cdo 6 muaj prane Agjencise Rajonale te Mjedisit dhe AKM-se.

EKSPERT MJEDISORE

YZEIR MIRAKA